

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Diaspora shqiptare mblidhet në Times Square në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, prefekti i Tiranës ndan pamjet
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/diaspora-shqiptare-mblidhet-ne-times-square-ne-mbeshtetje-te-ish-krereve--i104669
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:03:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	851dedd9f641575853c8ca40ab88ede5a4df1a1d17ecf8396ac0ddb0243fb996
TEKSTI	24b3e0065c28cd8ae7741da287cfb2ef51db9ebc0a268eabae91b35d99c1d92d
PAMJA	ae5cec6aea76c13eedd37dfcf51f92518d6132bccbe6bc0497c52e64da9997a2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	de6917a9bc6fbaceff55468f756387420407ca5a70afe88d46d44bdb8937d7b9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7da1a16455667271a66d1d30122b5a20135397a682b3b58f5cc074dfa4984ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/de6917a9bc6fbaceff55468f756387420407ca5a70afe88d46d44bdb8937d7b9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [prefektures italiane, kërkoi 3](#) ■ [me komet për probleme](#) ■ [Cristian Chivu për superpërballjen](#) ■ [paraajmerojne: Qëndrimi ynë nuk ndrvshon](#) ■ [konferencë p&eu...](#) ■ [deklarate të përbashkët: Nuk mund](#)

[KOSOVA](#)

Diaspora shqiptare mbledhet në Times Square në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, prefekti i Tiranës ndan pamjet

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 17:01



Pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë nga Dhomat e Specializuara në Hagë, me të cilin ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u dënuan me gjithsej 81 vite burgim, mbështetja për ta është shprehur edhe jashtë Kosovës.

Mbrëmjen e kaluar, shqiptarë të diasporës u mbledhën në Times Square, në zemër të Nju Jorkut, në një protestë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. Pjesëmarrësit shprehën kundërshtimin e tyre ndaj aktgjykimit dhe theksuan rëndësinë që, sipas tyre, ka ruajtja e kujtesës për luftën e Kosovës dhe sakrificën e popullit.

Pamje nga tubimi në Nju Jork ka publikuar në rrjetet sociale edhe prefekti i Tiranës, Shkëlqim Hajdari.

Në reagimin e tij, Hajdari tha se diaspora shqiptare u mbledh në Times Square për të shprehur mbështetjen për ish-krerët e UÇK-së, duke e cilësuar aktgjykimin ndaj tyre si të padrejtë.

“Dje në Manhattan, në Times Square! TË GJITHË BASHKË, PËR NJË QËLLIM — LIRI PËR ÇLIRIMTARËT!

Mbrëmë, diaspora shqiptare u mbledh si një trup i vetëm, me një zë dhe një qëllim: të qëndrojmë pranë vëllezërve tanë, ish-krerëve të UÇK-së, të cilët ne besojmë se janë dënuar padrejtësisht.

Pavarësisht se nga cila trevë shqiptare vijmë, sot na bashkon Kosova, na bashkon historia jonë dhe respekti për ata që luftuan dhe sakrifikuan për lirinë e saj. Nga Amerika e kudo në diasporë, mesazhi ynë është i qartë: nuk i harrojmë çlirimtarët tanë dhe nuk harrojmë sakrificën e popullit të Kosovës.

Së bashku kemi qenë në ditët më të vështira dhe së bashku do të vazhdojmë të qëndrojmë edhe sot — si vëllezër e motra, si një diasporë dhe si një komb.

LIRI • DREJTËSI • DINJITET

Së bashku për vëllezërit tanë. Së bashku për çlirimtarët”, shkroi Hajdari në Facebook.

????????????? Protests in support of former KLA leaders held in Times Square in New York. <https://t.co/fsoZ56gw7Q> pic.twitter.com/MB8xh2E50g

— kos_data (@kos_data) [September 17, 2026](#)

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 17 Shtator15:40

[“Nën hijen e flamurit”/ Gruaja e Rexhep Selimit reagon pas vendimit të Hagës](#)

Një ditë pas shpalljes së aktgjykimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë, ka reaguar publikisht Shqipe Mehmeti-Selimi, bashkëshort...

KOSOVA 17 Shtator15:31

[“Kundërshtojmë Gjykatën Speciale”/ Tjetër protestë në Prishtinë, Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë: Qëndrimi ynë nuk ndryshon](#)

Protesta do të mbahet në sheshin “Skënderbeu”, njoftimin e bëri të ditur Gazmend Sula gjatë një konference p&eu...

KOSOVA 17 Shtator15:04

[Mbështetën ish-krerët e UÇK-së, mediat serbe 'sulmojnë' Granit Xhakën, Dua Lipën dhe Rita Orën](#)

Qëndrimet e disa prej figurave shqiptare me njohje ndërkombëtare pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë kanë m...

KOSOVA 17 Shtator14:55

[Gjykata fajësoi Thaçin, por dokumenti i vitit 2000 sfidon versionin e Hagës për Behajdin Allaqin: Gruaja e tij tha se e mori policia serbe](#)

Një dokument hetimor i vitit 2000 po rikthen në qendër të vëmendjes rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit, një prej rasteve...

KOSOVA 17 Shtator14:31

[Haga dënoi me 81 vite burg ish-krerët e UÇK-së/ Studentët në Prishtinë nisin protestat: MARRE!](#)

Dhjetëra studentë janë grumbulluar në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë ditën e sotme, ndërsa po prot...

KOSOVA 17 Shtator10:07

[“Me kokën lart babë, gjithmonë!”/ Djali i Jakup Krasniqit me mesazh një ditë pas vendimit](#)

Pas aktgjykimit ndaj ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, djali i tij, Altin Krasniqi, ka reaguar përmes një mesazhi...

KOSOVA 17 Shtator09:07

[Kreu i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj](#)

Aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pritet të përballet me një proces t&eu...

KOSOVA 16 Shtator23:01

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi: Vendim i padrejtë, procesi nuk ka përfunduar](#)

Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi, Nik Gjelošhaj, ka reaguar pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hag&eu...

KOSOVA 16 Shtator22:57

[Dënimi i Hashim Thaçit/ Le Monde: Gjykata Speciale kontroverse, përdori edhe prova nga Beogradi](#)

Ish-presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, është dënuar me 25 vite burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë për krime luf...

KOSOVA 16 Shtator22:44

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Bardhi ndan foton e të riut: Mos u mërzhit, vëllai i vogël! Asnjë vendim nuk e ndryshon historinë e luftës çlirimtare](#)

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, ka reaguar sërish për dënimin e katër ish-krerëve të U&Cce...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktimë/ Prezantues...](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetarë televi...

LIFESTYLE 16 Shtator

[Prishtinë/ Shqiptarët protestojnë kundër vendim...](#)

Ndërkohë që në rrugët e Prishtinës po zhvillohen protesta e tubime lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




E premtë | ? 20:45 | ???? Syri TV






E premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.